



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2125 prot.

Tepelenë, më 22.06.2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. GRAMOS SAKO

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e premte më datë 26.06.2026, ora 10:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 28.05.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Maj 2026."
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2026."
5. **Projektvendim:** "Për transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë."
6. **Projektvendim:** "Për miratimin e planit të integritetit 2026-2028 Bashkia Tepelenë."
7. **Projektvendim:** "Për miratim të kërkesës, për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë."
8. **Projektvendim:** "Për miratimin e masave administrative dhe përcaktimin e kundërvajtjeve administrative në territorin e Bashkisë Tepelenë."

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al E-mail: info@tepelena.gov.al

9. **Projektvendim:** “Për miratimin e tarifave, rregullave të administrimit dhe përcaktimin e hapësirave të parkimit për mjetet publike dhe private në territorin e Bashkisë Tepelenë.”
10. **Projektvendim:** “Për miratimin e një shtese në kontratat e përdorimit të kullotave, lidhur me mirëmbajtjen e shtigjeve turistike dhe garantimin e sigurisë së vizitorëve.”
11. **Projektvendim:** “Për miratimin e standardeve dhe vendosjen e sinjalistikës turistike për shtigjet, monumentet e kulturës dhe atraksionet turistike në territorin e Bashkisë Tepelenë.”
12. **Projektvendim:** “Për miratimin e Manualit të Arredimit Urban për Kalanë e Tepelenës, zonën muzeale dhe fshatrat me prioritet zhvillimi turistik në territorin e Bashkisë Tepelenë.”
13. Informacion mbi Raportin e Performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2025.
14. Informacion mbi problematikat dhe masat e marra nga Sektori i MZSH- së për parandalimin e zjarreve për periudhën e nxehtë të verës.
15. Çështje të tjera.
16. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben GUMENI

